

ETLEVA LALA**FUQIZIMI I MBRETËRISË SË ARBËRISË NGA SELIA E SHENJTË****Abstrakt:**

Edhe pse Mbretëria e Arbërisë u shpall zyrtarisht pikërisht 750 vjet më parë, më 21 shkurt 1272, rëndësia e saj e vërtetë filloi të vihej në pah në dekadën e dytë të shek. XIV, shumë kohë pasi trupi fizik i mbretit të saj kishte vdekur. Trupi tjetër, ai politik i Mbretërisë së Arbërisë, u përdor nga Selia e Shenjtë për të krijuar një union të të gjitha palëve të interesuara katolike në Ballkanin Perëndimor, për të krijuar një kështjellë politike dhe religjioze në Ballkan, e cila nuk do të lejonte ritin lindor të merrte në dorë të gjithë Ballkanin. Ky union u bë akoma më organik dhe jetëgjatë, kur shqiptarët e kuptuan atë si një shprehje të identitetit të tyre dhe duke kombinuar vullnetin e tyre për të qenë të lirë nga mbretërit serbë me dëshirën për t'u njohur si një pushtet politik i pavarur, ata e përqaftuan idenë për ta parë veten si përfaqësues të Mbretërisë së Arbërisë në arenën ndërkombëtare politike dhe religjioze të asaj kohe.

Fjalë kyçe:

Regnum Albaniae, Mbretëria e Arbërisë, Selia e Shenjtë, Mesjeta e shqiptarëve, anzhuinët, identiteti, pushtimet serbe, dy-trupat e mbretit, histori e Ballkanit, Mesjetë.

Trupi fizik dhe trupi politik i Mbretërisë së Arbërisë

Mbretëria e Arbërisë¹ (*Regnum Albaniae*) u shpall zyrtarisht më 21 shkurt të vitit 1272, dhe në këtë vit, më 2022, mbush plot 750 vjet nga

¹ Studiuesi që është marrë më shumë me kontekstin e krijimit të *Regnum Albaniae* është Pëllumb Xhufi në disa nga artikujt e tij, por sidomos në librin *Dilemat e Arbërit: Një studim mbi Shqipërinë e shek. XI-XVI*, Tirana: Pegi, 2006; shih gjithashtu Pëllumb Xhufi, “Shqiptarët përballë anzhuinëve (1267-1285)”, në *Studime historike*, nr. 2, ASH, Instituti i Historisë, Tiranë: 1987, f. 199-222; po ai, “Vështrim mbi popullsinë e

koha që është krijuar. Vlera e vërtetë e këtij formacioni politik për shqiptarët nuk është kuptuar, në mos nuk është theksuar sa duhet në historiografi dhe natyrisht që nuk mund të kuptohet, nëse nuk njihet mirë filozofia dhe teologjia politike e Mesjetës, sado që të përshkruhet konteksti apo edhe vetë ky formacion politik sipas burimeve të shkruara që kanë arritur deri më sot dhe interpretimeve të tyre. Për të kuptuar rolin identitet-formues të shqiptarëve që ka luajtur kjo mbretëri në Mesjetë duhet të mendojmë siç mendohej në Mesjetë. “E shkuara është një vend i huaj. Atje gjërat bëhen ndryshe.”²

Në Mesjetë mbreti kishte dy trupa sipas studiuesit Kantorowitz:³ trupin fizik dhe trupin politik. Trupi fizik i mbretit është një trup i vdekshëm, i nënshtruar ndaj të gjitha dobësive që vijnë nga natyra. Trupi politik i mbretit është trupi që nuk mund të shihet me sy fizikë dhe as të rrënohet nga koha apo nga vullneti i njerëzve. Ai përbëhet nga politika, qeverisja, nga menaxhimi i pasurive publike, si dhe nga roli reprezentativ që zë në arenën politike. Ky trup është i paprekshëm nga mosha dhe nga natyra, të cilave u nënshtrohet trupi fizik. Ndërsa trupi fizik i mbretit mund të vdesë, trupi politik i tij nuk vdes kurrë. Mbretëria vazhdon të ekzistojë edhe pa trupin fizik të mbretit, sepse kur krijohet një mbretëri, sipas filozofisë dhe teologjisë politike mesjetare, ajo krijohet në qiell dhe si e tillë nuk varet më nga njerëzit.

Se sa të ndërgjegjshëm ishin vetë arbërorët e Mbretërisë së Arbërisë për këtë kuptim mistik që kishte mbretëria në të cilën ata bënin pjesë, është një çështje që kërkon vëmendje të veçantë, gjë që nuk është fokusi i studimit në fjalë. Edhe për vetë Karlin I Anzhu nuk mund të themi që ishte plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë që kishte mbretëria që ai krijoi, sepse interesat e tij *ad hoc* për krijimin e Mbretërisë së Arbërisë ishin larg atyre teologjiko-mistike.⁴ Që Selia e Shenjtë ishte plotësisht e

qyteteve bregdetare shqiptare në shek. XII-XV”, në *Studime historike*, nr. 4, ASH, Instituti i Historisë, Tiranë: 1982, f. 147-156.

² Leslie Poles Hartley, *The Go-Between*, New York: New York Review of Books, 2002 f. 39.

³ Për të njohur filozofinë dhe teologjinë politike të Mesjetës në lidhje me domethënien e krijimit të një mbretërie të re, studiuesi më i njohur që duhet konsultuar është Ernst Kantorowitz, me studimin e tij “Dy Trupat e Mbretit.” Ernst Kantorowitz, *The King's Two Bodies: A Study in Mediaeval Political Theology*, Princeton University Press: 1957.

⁴ Në këtë studim nuk po merremi me fillimet e Mbretërisë së Arbërisë, prandaj për të interesuarit në lidhje me këtë periudhë sugjerojmë literaturën e mëposhtme: Alain

ndërgjegjshme për kuptimin teologjiko-politiko-filozofik që kishte krijimi dhe ekzistenca e një mbretërie, kjo nuk ka asnjë dyshim dhe këtë do ta dëshmojë më së miri pikërisht ky studim.

Mbretëria e Arbërisë pas vdekjes së Mbretit të saj, Karl I Anzhu

Dokumentet e para papnore, në të cilat përmendet Mbretëria e Arbërisë me emrin *Regnum Albaniae*, datojnë nga dhjetëvjeçari i dytë i shek. XIV dhe pikërisht nga viti 1317,⁵ në një kohë kur mendohej që

Ducellier, me veprat e tij: *La façade maritime de l'Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XIe au XVe siècle*, Institute for Balkan Studies, Thessaloniki: 1981; po ai, *L'Albanie entre Byzance e Venice, X^e-XV^e siècles*, London: Variorum Reprints, 1987; Gennaro Maria Monti, "La dominazione napoletana in Albania. Carlo I d'Angiò, primo re degli Albanesi", *Rivista d'Albania*, Academia d'Italia, Roma: 1940, f. 50-58; po ai, *Nuovi Studi Angioini*, Trani: Vecchi e C., 1937; po ai, *Da Carlo I a Roberto die Angiò: Ricerche e documenti*, Trani: Vecchi e C., 1936; po ai, "Ricerche sul dominio angioino in Albania IV: Una leggendaria principessa angioina moglie di un dinasta Albanese", *Studi Albanesi*, 5-6, Roma: Istituto per l'Europa Orientale: 1935-1936, f. 1-32; po ai, *Les Anjous de Naples: Les Anjous de Naples dans les études du dernier demi-siècle*, Blois: J. de Grandpré, 1934; po ai, "Studi di storia Angioina", *Rivista Storica*, I, Pinerolo: 1932, f. 1-25; po ai, "Studi di storia Angioina. Roberto di Angiò e la crisi del regno di Sicilia," *Rivista Storica*, 3, Pinerolo: 1931, f. 1-24; po ai, "Una storia Italiana dei Tartari e dei loro rapporti con l'Europa Cristiana," *L'Europa Orientale* 5-6, Roma: 1931, f. 1-14; po ai, "Due documenti sconosciuti sull'Albania di Alfonso I di Aragona," *Studi Albanesi* I, Roma: Istituto per l'Europa Orientale, 1931, f. 1-10; po ai, *Mezzogiorno d'Italia nel medioevo: Studi Storici*, Bari: Laterza, 1930; David Abulafia, "The Aragonese Kingdom of Albania: an Anjou Project of 1311-1316", *Mediterranean Historical Review* 10, Intercultural Contacts in the Medieval Mediterranean. Studies in Honour of D. Jacoby, Routledge: 1995, f. 1-13; po ai, "Charles of Anjou reassessed", *Journal of Medieval History* 26, no. I, Elsevier, mars 2000, f. 93-114; po ai, *Western Mediterranean Kingdom, 1200-1500: The Struggle for Dominion*, London: Longman, 1997; po ai, *Italy, Sicily and the Mediterranean 1100-1400*, London: Variorum Reprints, 1987; po ai, "Genoa and the Security of the Seas: the Mission of Babilano Lomellino in 1350," *Papers of the British School at Rome*, Cambridge University Press, 1977, f. 272-279.

⁵ *Archivio Apostolico Vaticano* [më tej: AAV], *Registri Avignonensi* [më tej: *Reg. Avin.*] 2, f. 183; *Registi Vaticani* [më tej: *Reg. Vat.*] vol. 63, f. 363v. Ky dokument përmendet gjithashtu edhe në: *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* edituar nga Ludwig von Thallóczy, Konstantin Jireček dhe Milan Šufflay, vol. I, Vjenë: Typis Adolphi Holzhausen, 1913 (më tej: AA. I), dok. nr. 633, dhe si regestë edhe në Guillaume Mollat, *Jean XXII (1316-1334). Lettres communes, un fascicule d'introduction et 16 tomes en 31 fascicules (fascicules 19, 21/2, 23 épuisés)*, (Paris: 1921-1947), dok. nr. 5251 (reg). Redaktuar nga Guérard, *Documents pontificaux sur*

Mbretëria e Arbërisë nuk ekzistonte më, sepse që nga koha, kur Karl I Anzhu kishte vdekur tashmë, më 7 janar 1285,⁶ jo vetëm që nuk kishte pasur mbret tjetër të Mbretërisë së Arbërisë, por as përpjekje për ta mbajtur gjallë atë si mbretëri.

Përmendja e *Regnum Albaniae* në kancelarinë e Selisë së Shenjtë në pamje të parë dukej si një gabim apo keqkuptim, por kur këto dokumente filluan të shpeshtoheshin përgjatë gjithë shekullit të katërbëdhjetë dhe shkaktuan veprim politik në Ballkan, sigurisht që nuk mund të flitej më për rastësi apo për keqkuptim, por për një përdorim të qëllimshëm të strukturës politike *Regnum Albaniae*, e cila sipas filozofisë dhe teologjisë mesjetare ishte po aq e gjallë dhe reale sa ç'ishte në kohën kur jetonte Mbreti i saj i vetëm legjitim, Karli I Anzhu.

Dokumenti i parë që fillimisht e morëm për një *lapsus* të kancelarisë së Selisë së Shenjtë, gjatë kohës së hulumtimit arkivor në Arkivin Apostolik të Vatikanit (në atë kohë të quajtur Arkivi Sekret i Vatikanit), daton nga maji i vitit 1317⁷ dhe tjetri po ashtu nga shtatori i po këtij viti 1317.⁸ Pasi vumë re frekuencën e shfaqjes së termit *Regnum Albaniae* në dokumentet e Selisë së Shenjtë dhe filluam të studiojmë përmbajtjen e tyre për të kuptuar se përse Selia e Shenjtë ishte kaq 'e painformuar' sa të vazhdojë të përdorë emrin e një mbretërie 'jo-ekzistente', vumë re që dokumenti i majit ishte shkruar pikërisht në kohën kur në Selinë Papnore kishin arritur sinjalet e para për persekutimet që mbretërit serbë kishin filluar t'u shkaktojnë katolikëve shqiptarë.

Dokumenti i parë, kur fillon të përdoret termi *Regnum Albaniae* (Mbretëri e Arbërisë) në kancelarinë papnore, është një dokument i veçantë që daton nga 10 maji i vitit 1317. Në të, Papa Gjoni XXII kërkon

la Gascogne d'après les archives du Vatican, vol. I, Paris: Honoré Champion, 1896, dok. nr. 14.

⁶ Steven Runciman, *The Sicilian Vespers: A History of the Mediterranean World in the Later Thirteenth Century*, Cambridge University Press, 1985, f. 255.

⁷ Dokumenti ruhet në: AAV (*olim ASV*) *Reg. Avin.*, vol. 2, f. 183 dhe *Reg. Vat.*, vol. 63, f. 363v.

⁸ Kjo letër ishte regjistruar në AAV, *Reg. Avin.* 8 f. 70 ep. 96 dhe AAV, *Reg. Vat.* 67, f. 26, ep. 96. Redaktuar nga Aloysius L. Täutu, *Acta Joannis XXII (1317-1334) e registris vaticanis aliisque fontibus. Fontes Pontificia Commissio ad redigendum Codicem Juris Canonici Orientalis*, Roma: Typis Pontificiae Universitatis Gregoriana, 1952, nr. 4, f. 5, por përpara kësaj është përmendur në formë regeste nga G. Mollat, *Jean XXII*, nr. 5629.

që Guljelm Montegrano, ipeshkvi i Kunavisë, në kryeipeshkvinë e Durrësit, në Mbretërinë e Arbërisë, të paraqitet në Avinjon:

“Përshëndetje vëllait tonë të nderuar, kryeipeshkvit së Auxitës. Duke qenë se urdhërojmë vëllanë tonë të nderuar Guljelmi i Montegrano, ipeshkvi i Kunavisë, nga kryeipeshkvia e Durrësit në mbretërinë e Arbërisë, nëpërmjet një dokumenti apostolik që për arsye të caktuara, të jetë i pranishëm, ju dhe vëllazëria juaj ta shoqëroni me dikë që mund të dalë nga ju ose nga një tjetër ose të tjerë nga ana jonë, në mënyrë që pasi të lexohet letra jonë, brenda njëzet ditësh ai personalisht të paraqitet në praninë tonë. Megjithatë, mund të na informoni me detaje të plota për datën e leximit të letrës, formën dhe çdo gjë që mendoni se është bërë për llogari të tij. Lëshuar në Avignon.”⁹

Duke qenë se nga kjo letër akoma nuk mund të mësojmë arsyen se përse përmendet *Regnum Albaniae*, dhe madje as se përse Guljelmi i Montegrano, ipeshkvi i Kunavisë duhet të nxitojë për në Avinion, ku ishte Papa Gjoni XXII në atë kohë skizme, të paktën mund të marrim vesh që rruga nga Durrësi në Avinion nuk duhet të zgjaste më shumë se 20 ditë nga dita që merrej informacioni. Sigurisht që letra apostolike i ka hapur të gjitha rrugët Guljelmit, sepse një letër e tillë papnore jo vetëm shërbente si pasaportë në Mesjetë, por i detyronte të gjithë që t’u jepnin prioritet kërkesave të Guljelmit, çfarëdo që të ishin ato. Ai duhet të jetë nisur me anijen e parë, ose me mjetin e parë të transportit në çdo stacion, pasi ka marrë letrën, sepse askush nuk mund të nxirrte pengesë apo ta vononte, në mënyrë që të mos binte *ipso facto* në ndonjë mallkim apo shkishërim.

⁹ “*Venerabili fratri Archiepiscopo Auxitanensis salutem. Cum venerabilis fratris nostri Guillelmo de Montegrano episcopo Cunaviensis de Archiepiscopatu Duraseno in Regno Albaniae ex certis causis sic nobis presentia oportuna tibi fraternitati tue per apostolica scripti mandamus quatenus ipsium apostolicam per te vel alium seu alios ex parte nostra perempertoris citare provenires ut infra viginti dierum spatium post citationem huiusmodi se coram nobis personaliter representet. Diem vero citationis et formam et quoquod inde duxeris faciendum nobis per tuas literum seriem continentes studeatis fidelitem intimare. Datum Avinionen.*”

Mbretëria e Arbërisë si formacion politik katolik në Ballkan kundër mbretërve serbë

Pas këtij dokumenti të Kancelarisë Papnore, bula të shumta papnore në të cilat përmendet *Regnum Albaniae*, vazhdojnë të dalin nga kjo kancelari duke filluar nga viti 1317 deri në vitin 1320. Të gjitha këto bula, direkt apo indirekt, kanë lidhje me një kryengritje që po përgatitej kundër kërcënimit serb në trojet shqiptare, kërcënim ky që vinte nga sulmet e vazhdueshme të ushtrisë së mbretërve serbë, që u shkaktonte shumë vuajtje jo vetëm shqiptarëve, por sidomos katolikëve të territoreve shqiptare. Pushtimet e tokave shqiptare të mbretërve serbë kishin marrë përmasa si kurrë më parë në fillim të shek. XIV.¹⁰ Në lidhje me arsyet e këtyre pushtimeve të Mbretit serb Urosh II, Xhufi shkruan që ato “ishin një sfidë e hapur ndaj anzhuinëve, që ishin titullarë ‘ligjorë’ të së ashtuquajturës ‘Mbretëri e Arbërit.’”¹¹ Sipas tij, në këtë prishje të marrëdhënieve deri atëherë miqësore të anzhuinëve me serbët ndikoi edhe vdekja e Mbretëreshës Helena, në vitin 1314, nëna e Uroshit II, e cila ishte me origjinë franceze, që ishte “një hallkë jo pa rëndësi që lidhte oborrin anzhuin me atë serb.”¹²

Në të gjitha bulat papnore që datojnë nga viti 1317 deri në vitin 1320 vihet re një figurë shumë e rëndësishme shqiptare e kësaj periudhe, Ndreu, ipeshkvi i Krujës, i cili në dokumentet papnore njihet si Andrea Croensi.¹³ E quajmë shqiptar, sepse përdorimi i vendit të prejardhjes si mbiemër është karakteristikë sidomos e shqiptarëve në Mesjetë, gjë që dokumentohet rregullisht në të gjitha dokumentet latine, ku përmenden

¹⁰ P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 251-255; John V. A. Fine, Jr, *The Late Medieval Balkans. A Critical Survey from the Late Twelfth Century to the Ottoman Conquest*, Ann Arbor: The University of Michigan Press, 1994, f. 255-266.

¹¹ P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 253.

¹² *Po aty*.

¹³ Conrado Eubel, *Hierarchia Catholica Medii Aevi sive Summorum Pontificum S.R.E. Cardinalium, Ecclesiarum Antistitum Series ab anno 1198 usque ad annum 1431 perducta e documentis tabularii praesertim vaticani*, vol. I, Monasteri, Regensburg: 1898, f. 216; Andreas Croensis është përmendur vetëm në vitin 1318 dhe më 1320; Giorgio Fedalto, “La Chiesa Latina in Oriente”, në *Studi Religiosi*, vëll. I-III, Mazziana, 1981, i përcakton më saktësisht datat (6 qershor 1318 dhe 16 korrik 1320), por nuk jep më shumë hollësi se Daniele Farlati, Jacopo Coleti, *Illiricum Sacrum*, vëll. VII, Venecie: 1817, f. 196A.

shqiptarët. Analizën e këtyre dokumenteve do ta fillojmë me këtë figurë, sepse bula e dytë që regjistrohet, pas asaj të mësipërme, flet pikërisht për gjëmën personale por edhe institucionale që i ka ndodhur Ndreut. Ajo do të bëhet pikënisje për të gjitha dokumentet e mëtejshme të dala nga kancelaria papnore.

Dy herë është regjistruar në kancelarinë papnore bula e 17 shtatorit 1317: në regjistrat e Avinjonit edhe në regjistrat e Vatikanit, ndërkohë që bula origjinale është dërguar në destinacion. Nga kjo bulë marrim vesh që Ndreu, ipeshkvi i Krujës dëbohet nga posti i tij si ipeshkëv i Krujës nga serbët që kanë pushtuar Krujën. Mbreti serb Uroshi II (1282-1321), edhe pse i martuar me Simonën në vitin 1299, vajzën e Perandorit bizantin Androniku II,¹⁴ kërkon të shtrijë territoret e tij në kurriz të Perandorisë Bizantine. Më poshtë po japim përkthimin e kësaj letre, për të kuptuar jo vetëm se çfarë i ka ndodhur Ndreut, por edhe mënyrën se si Selia e Shenjtë kujdesej për ipeshkvijt dhe kishat katolike edhe në tokat shqiptare.

“Përschëndesim vëllezërit e nderuar të Oristanit dhe Brindizit dhe kryepeshkvët e Tarantos. Përsa i përket vëllait tonë të nderuar Andrea, ipeshkv i Krujës, i cili, është dëbuar me forcë nga kisha e tij e pushtuar nga mbreti skizmatik i Rashës, Uroshi, ne e drejtojmë vëmendjen tonë tek vizioni i Selisë Apostolike. Ne kemi një dashuri atërore për të dhe e konsiderojmë të denjë dhe të domosdoshme që të ndikojmë në sajë të mirësinë së Selisë Apostolike dhe hirit të saj të bollshëm dhe devotshmërisë së shtuar, që ai të mos detyrohet të lypë, gjë që është fyerje ndaj detyrës pontifikale. Ne, pra, duke dashur ta ndihmojmë atë ipeshkv me anën ndihmave, urdhërojmë vëllazërinë tuaj nëpërmjet shkrimeve apostolike, që ju ose dy ose njëri prej jush, nëpërmjet jush ose një tjetri ose të tjerëve, të ndani nga të mirat e Shën Mërisë së Baritia dhe Shën Nikollës e manastireve të Shën Vasilit dhe Shën Benediktit të secilit prej urdhrave të të njëjtave manastire, mbi pesëdhjetë florinj ari nëpërmjet bijve tanë të dashur, igumenit të Shën Mërisë dhe Shën Nikollës dhe prijësit të St. Angelo, gjë e cila hiqet dhe vendoset sipas dëshirës nga igumeni i Shën Nikollës, sipas dëshirës së manastireve të sipërpërmendur dhe manastirit të tyre; të përgjigjet plotësisht, pavarësisht nga çdo gjë që është në kundërshtim me statutet dhe zakonet e manastireve dhe urdhrave të

¹⁴ Konstantin Jireček, *Geschichte der Serben*, I, Gotha: F. A. Perthes, 1911, f. 347-348.

sipërpërmendur; si dhe asamblëtë ose ndonjë tjetër, së bashku ose veçmas, Megjithatë, nëse ipeshkvi i lartpërmendur do të jetë rikthyer paqësisht në kishën e tij brenda pesë viteve të përmendura, ose të jetë transferuar në një tjetër, ai do të ishte krejtësisht i varfër nga ky pension vjetor. Lëshuar në Avignon, më 5 tetor, viti i dytë.”¹⁵

¹⁵ “*Venerabilibus fratribus Albonensi et Brundusino ac Tarentino archiepiscopis salutemus. Dum ad personam venerabilis fratris nostri Andreae episcopi Croiensis, qui ab ecclesia sua, per Urosium regem Rasciae schismaticum occupata, expulare compellitur, apostolicae vertimus considerationis intuitum, affectu sibi non immerito paterno compatimur ac dignum et debitum arbitramur, ut circa eum Apostolicae Sedis benignitas influat, exuberet gratia et pietas augeatur, ne in obproprium pontificalis cogatur officii mendicare. Nos igitur eidem episcopo de alicuius subventionis auxilio subvenire volentes, fraternitati vestrae per apostolica scripta mandamus, quatenus vos vel duo aut unus vestrum, per vos vel alium seu alios, de bonis Sanctae Mariae de Baritia et Sancti Nicolaum monasteriorum Sancti Basilii et Sancti Benedicti ordinum singulorum videlicet eorundem monasteriorum, in quinquaginta florenos auri per dilectos filios abbates Sanctae Mariae et Sancti Nicolai et Priorem Sancti Angeli, qui per ipsum abbatem Sancti Nicolai amovetur et ponitur pro libito voluntatis, monasteriorum praedictorum eorumque Conventus, faciatis eidem episcopo annis singulis usque ad quinquennium provideri et integraliter responderi, non obstantibus quibuscunque statutis et consuetudinibus contrariis monasteriorum et Ordinum praedictorum, aut si pro similibus provisionibus aliquibus faciendis de bonis praedictorum monasteriorum scripta apostolica sint directa, quibus per hoc nullum praediudicium generetur seu si eisdem abbatibus et Conventibus vel quibusvis aliis communiter vel divisim ab eadem sit Sede indultum, quod ad providendum cuiquam de huiusmodi pensionibus minime teneantur, quodque ad id compelli aut quod interdici, suspendi vel excommunicari non possint, per litteras apostolicas non facientes plenam, et expressam ac de verbo ad verbum de indulto huiusmodi mentionem et qualibet alia praefatae Sedis indulgentia generali vel speciali cuiuscunque tenoris existat, per quam effectus praesentium impediri valeat vel differi et de qua cuiusque toto tenore de verbo ad verbum habenda sit in nostris litteris mentio specialis. Contradictores per censuram ecclesiasticam. Appellatione postposita, compescendo. Volumus autem, quod si praefatus episcopus infra dictum quinquennium ad suam pacifice fuerit ecclesiam restitutus aut ad aliam translatus extiterit huiusmodi pensione annua sit penitus destitutus. Datum Avinione, V kalendas octobris, anno secundo” Kjo letër ishte regjistruar në AAV, Reg. Avin. 8 f. 70 ep. 96 dhe AAV, Reg. Vat. 67, f. 26, ep. 96. Redaktuar nga Aloysius L. Taùtu, *Acta Joannis XXII (1317-1334) e registris vaticanis aliisque fontibus. Fontes Pontificiae Commissio ad redigendum Codicem Juris Canonici Orientalis* 4, Roma: Typis Pontificiae Universitatis Gregorianae, 1952, f. 5 (cituar më tej: A. Taùtu, *Acta Johannis XXII*), por përpara kësaj është përmendur në formë regeste nga Mollat, *Jean XXII*, nr. 5629.*

Bula, në të cilën Papa Gjoni XXII bën të njohur dëbimin e Ndreut nga ipeshkvia e tij, u drejtohet ipeshkvijve të Oristanit¹⁶ në Sardenjë, të Brindisit¹⁷ dhe të Tarantos¹⁸ në Pulje të Italisë. Pasi u tregon atyre se çfarë i ka ndodhur Ndreut “të përzënë me forcë nga kisha e tij prej Uroshit, mbretit skizmatik të Rashës” (*ab ecclesia sua, per Urosium regem Rasciae schismaticum occupata, exulare compellitur*), u bën thirrje që ta ndihmojnë Ndreun duke i siguruar atij një pension prej 50 florenos auri nga të ardhurat e 5 manastireve “për 5 vjet” (*quinquennium*).¹⁹ Me sa duket gjendja ekonomike e Ndreut ka vazhduar të jetë e keqe, sepse më 18 qershor të vitit 1320, Papa Gjon XXII i dha atij, si dhe kryepeshkvit të Ohrit e ipeshkvit të Shasit, 100 “florinj/monedha ari” (*florenos auri*)²⁰ për shkak të gjendjes së mjerueshme të tyre, si rrjedhojë e shkatërrimeve të bëra nga mbreti serb.

Për shkak të vuajtjeve që iu shkaktuan Ndreut nga Mbreti serb Urosh II, si dhe për hir të përkushtimit të tij ndaj kauzës që mbronte, Ndreu fiton jo vetëm respekt, por edhe një besim të madh të Papa Gjorit XXII, aq sa atij i besohen detyra që normalisht i besoheshin vetëm një legati apostolik.²¹ Bula e datës 6 qershor të vitit 1318, po e Papa Gjorit XXII, i

¹⁶ C. Eubel, *Hierarchia Catholica Medii Aevi ...*, vol. I, f. 102. Sipas Eubelit, ipeshkvi i Oristanit të Sardenjës ishte Guido. Guido (Cattano) i Urdhrit të Predikatorëve ishte zgjedhur, më 10 maj të vitit 1312.

¹⁷ *Po aty*, f. 154. Po sipas Eubelit, ipeshkvi i Brindizit ishte Bartolomeu, i cili ishte zgjedhur më 22 janar të vitit 1306 dhe kishte vdekur në vitin 1319.

¹⁸ *Po aty*, f. 498. Ipeshkvi i Tarantos, sipas Eubelit ishte Gregori i Urdhrit të Predikatorëve, i cili ishte zgjedhur në vitin 1301 dhe kishte vdekur në vitin 1334.

¹⁹ Shih shënimin 22.

²⁰ “*Die XVIII Junij tradidimus de mandato domini nostri papae ex causa helemosinae venerabilibus patribus dominis fratribus Nicolao archiepiscopo Acridensis et Andree episcopo Croensis et Zacarie Suassinensis C florenos auri*”. Ky tekst është regjistruar në regjistra të ndryshëm të AAV: Camera Apostolica; Introitus et Exitus [*Cam. Ap., Intr. et Ex.*], 33, f. 142v; pastaj edhe në AAV, *Cam. Ap., Intr. et Ex.* 38, f. 107v. (G. Garampi jep një vendndodhje të gabuar në *Vescovi* 44, *Indice* 488, f. nr. 105v, dhe M. Shuflaj jep gjithashtu një vendndodhje të gabuar *A.A I*, nr. 663. Regjistrimi i tretë është në *Cam. Ap., Intr. et Ex.* 564, f. 102v (ol. 95v).

²¹ Në lidhje me legatët shih Etleva Lala, “The Impact of Medieval Papal Legates and Nuncios on the Albanians”, in *Sprache und Kultur der Albanen: Zeitliche und räumliche Dimensionen. Akten der 5. Deutsch-albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung* (5.–8. Juni 2014, Buçimas bei Pogradec, Albanien), Wiesbaden: Harrassowitz, 2015, f. 120-138; S. J. Pierre Blet, *Histoire de la Représentation Diplomatique du Saint Siège des origines à l’aube du XIX^e siècle*, Collectanea Archivi Vaticani 9, Vatican City: Archivio Vaticano, 1982; Robert C. Figueira, “The Classification of

drejtohet Ndreut (që vazhdon të njihet si ipeshkvi i Krujës), si dhe Mihalit, ipeshkvit të Arbrit.²² Nuk e dimë nëse Ndreu është kthyer në ipeshkvinë e tij, sepse një gjë e tillë nuk përmendet në bulë, por ajo që në radhë të parë të tërheq vëmendjen në këtë letër është prezenca e dy ipeshkvide të ndryshme për një vend, që ne deri tani e kemi identifikuar si një të vetëm:²³ ipeshkvia e Krujës dhe ipeshkvia e Arbrit.

Ipeshkvia e Krujës dhe e Arbërisë

Në fakt një surprizë e tillë e dy ipeshkvide të ndryshme, kur bëhet fjalë për Krujën dhe Arbërinë, nuk është e veçuar. Në *Hierarchia Catholica*, të Eubelit,²⁴ e cila konsiderohet si vepra më monumentale për sa i përket renditjes së ipeshkvide dhe të ipeshkvijve në botën katolike, Arbëria dhe Kruja konsiderohen si dy ipeshkvi krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, me ipeshkëv të ndryshëm. Në këtë vepër monumentale, ipeshkvi i parë i Krujës²⁵ përmendet në vitin 1286 dhe pikërisht kur ishte ipeshkëv Romani, që gjendet edhe në librin e shenjtoreve. Pas Romanit kemi Ndreun, pastaj Grigorin, në vitin 1366 Ndreun e minoritëve dhe më pas Gjonin. Lista e ipeshkvijve vazhdon edhe pas vitit 1400 me Gualterin dhe pas atij Silvestrin, Palin në vitin 1458 dhe Pjetrin në vitin 1468 etj.²⁶

Në Arbëri (*Arbanensis*), ipeshkvi i parë i njohur nga Eubeli²⁷ përmendet në vitin 1295 dhe është Mikeli. Megjithatë, në letrën e datës

Medieval Papal Legates in the *Liber extra*,” në *Archivum historiae pontificiae* 21, Romë: Gregorian Biblical Press, 1983, f. 211-228; Richard A. Schmutz, “Medieval Papal Representatives: Legates, Nuncios, and Judges delegate,” në *Studia gratiana* XV, Romë: 1972, f. 441-463; Karl Ruess, *Die rechtliche Stellung des päpstlichen Legaten bis Bonifaz VIII*, Paderborn: F. Schöningh, 1912.

²² *ASV, Reg. Avin.* 9, fol 281r-v; *Reg. Vat.* 68, f. 106. Përmendet gjithashtu edhe nga Daniele Farlati, Jacopo Coleti, *Illiricum Sacrum*, vol. VII, Venecie: 1817, f. 196A, në vitin 1317; si dhe në faqen 191B, në vitin 1316. Në faqen 366A përmendet në vitin 1318.

²³ Kjo pasaktësi buron nga një interpretim i gabuar i Shuflajt, në veprën “Die Kirchengestaltung im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchzone im katholischen Damme,” në *Illyrisch-albanische Forschungen*, vol. I, München, Leipzig: Verlag von Duncken und Humlot, 1916, f. 195, ku Shuflaj hedh idenë se ipeshkvia e Arbërisë dhe e Krujës kanë qenë një, deri në shek. XIII, ide kjo që edhe nëse është e vërtetë, vlen vetëm deri në shek. XIII, e jo më vonë.

²⁴ C. Eubel, *Hierarchia*, vëll. I, f. 224.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Po aty*, f. 101.

28 shkurt të vitit 1208, të cilën Papa Inocenti III ia drejton princit shqiptar Dhimitër Progoni, është përmendur Pali, si ipeshkëv i Arbërisë.²⁸ Tani për tani nuk kemi indikacione për ipeshkvijt e periudhës midis vitit 1208 dhe vitit 1295, por kërkimet e mëtejshme arkivore mund të na ofrojnë surpriza të këndshme në lidhje me ta. Lista e ipeshkvijve të Arbërisë vazhdon pas Mihalit me Martinin (1306), Mihalin II (1307), Llazrin, Laurin (1350), Nikollën (1354), një të panjohur dhe pastaj me Dominikun në vitin 1372, Gjon Lurlin në vitin 1370, Gjon Tergesten në vitin 1391, Thomanë, Gjergjin, Ndreun, Vulkan Suintin, Ndre Sumën në vitin 1425 etj.²⁹

Meksi³⁰ gjithashtu e merr në shqyrtim çështjen e ipeshkvisë së Arbrit dhe të Krujës duke iu referuar literaturës, si dhe burimeve. Interesante në gjurmimin e tij, është fakti që ai konsideron Drinov-in³¹ të parin që krijon hipotezën që ipeshkvia e Arbërisë dhe e Krujës konsiderohen si e njëjta ipeshkvi, duke u shprehur që Shuflaj me siguri është bazuar te Drinov, kur e shtron këtë çështje në *Acta Albaniae*.³² Edhe Salaville e thekson këtë në studimin e epitafit të Konstantin Meles,³³ kryediakonit të Arbërisë, që daton rreth fundit të shek. XIII, madje edhe Ducellier³⁴ mendonte po kështu, shton Meksi. Kristo Frashëri hedh hipotezën që Kruja ishte qendra e dioqezës së Arbërisë, dhe kur Lezha dhe Stefaniaka

²⁸ AAV, *Reg. Vat. 7A*, f. 49v. Nuk është për t'u fajësuar C. Eubeli për këtë "gabim", pasi në studimin e tij ai është mbështetur në veprën monumentale katalogizuese dhe sistematizuese të Garampit që njihet me emrin *Schedario Garampi* dhe gjendet në Arkivin Apostolik të Vatikanit (vëllimi *Reg. Vat. 7A*, f. 49v, ku gjendet ky dokument). Ky dokument ka hyrë në *Arkivin Sekret të Vatikanit* pas prefekturës së Garampit, kështu që ai nuk kishte si ta njihte dhe t'i referohej atij. Për këtë shih Germano Gualdo, "Sussidi per la Consultazione dell'Archivio Vaticano", në *Collectanea Archivi Vaticani*, vol. 17, botuar nga Arkivi i Vatikanit në vitin 1989, f. 158, shënimi 4.

²⁹ C. Eubel, *Hierarchia* vëll. I, f. 101.

³⁰ Aleksandër Meksi, "Arbanense bishopric, Gjon Kastrioti and the quarrel about the borders of the bishopric Lezha's", *Studia Albanica* I, Tiranë: 2019, f. 3-42, shih veçanërisht f. 15.

³¹ M. S. Drinov, *Trudove po Bullgarska i Sllavianska istorija*, Sofija: 1909, f. 587.

³² AA, I, 48.

³³ Sèvèrien Salaville, "Építaphe métrique de Constandin Meles, Archidiacre d'Arbanon", *Échos d'Orient*, vol. 27, no. 149, Paris: 1928, f. 410-413.

³⁴ Alain Ducellier, *La façade maritime de l'Albanie au Moyene Âge (Durazzo et Valona du XIe au XVe siècle)*, Institute for Balkan Studies, Thessaloniki: 1981, f. 108.

u renditën në Kishën Latine, u shkrinë në një që ishte ajo e Arbrit.³⁵ Ndryshe nga këta, Shuteriqi i konsideron këto dy ipeshkvi si dy të ndryshme nga njëra-tjetra deri në fund të shek. XIV.³⁶

Ipeshkvi Ndreu i Krujës, zëri i gjallë i Papa Gjonit XXII në Ballkan

Megjithatë, le të kthehemi te letra e Papa Gjonit XXII drejtuar Ndreut, ipeshkvit të Krujës, dhe Mihalit, ipeshkvit të Arbërisë, në të cilën letër mirëbesimi i Papës vihet re në detyrën që ai u ngarkon këtyre dy ipeshkvijve: të konfirmojnë zgjedhjen e Kostës si kryediakon të Durrësit. Po të kësaj date janë edhe dy letra të tjera të Papa Gjonit XXII, në të cilat Ndreut i ngarkohen detyra të tjera si, p.sh. të konfirmojë zgjedhjen e Gjon Rubeut në famullinë e kishës së Shën Nikollës së Petrozës në dioqezën e Kunavisë,³⁷ e cila sipas Shuflajt ishte një famulli shumë e pasur, si dhe të konfirmonte emërimin e Gjon Barbucit në famullinë e dioqezës së Barit.³⁸ Po të kemi parasysh që Papa Gjoni XXII, gjatë pontifikatit të tij, e përqendroi të gjithë sistemin e zgjedhjes, të nominimeve dhe të konfirmimeve në duart e veta, mund të kuptojmë shumë mirë se çfarë besimi kishte fituar Ndreu te Papa Gjoni XXII: ai ishte praktikisht një ndër njerëzit më të besuar të tij.

Kur filloi pontifikati i Papa Gjonit XXII (në vitin 1316), Kuria Papnore ishte mjaft e çorganizuar nga periudha e gjatë e mungesës së një pape dhe thesari apostolik ishte i boshatisur si nga donacionet e ekzagjeruara të lëna me testament të Papës paraardhës Klementi V, ashtu edhe nga përpjekjet për pavarësi të këtij pape si dhe nga luftërat në Itali e në Orient. Kështu Papa Gjonit XXII iu desh të bëjë një punë kolosale për të vendosur rregull dhe pasuri në Selinë e Shenjtë. Për suksesin e arritur ai u konsiderua edhe “administrator i pakrahasueshëm,” por për të ardhur deri te sukseset iu desh që të ngrëjë një sistem të tërë fiskal që të rriste fuqinë monetare të Selisë së Shenjtë, si dhe iu desh të centralizonte të

³⁵ Kristo Frashëri, “Trojet e shqiptarëve në shekullin XV”, *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 201-202.

³⁶ Dhimitër S. Shuteriqi, “Mbi disa çështje të Arbërit dhe mbi emrin Shqipëri,” *Buletin për shkencat shoqërore*, 3, Instituti i Shkencave, Tiranë: 1956, f. 199-201.

³⁷ AAV, *Reg. Avin.* 9, f. 187r, ep. 1324, si dhe AAV, *Reg. Vat.* 68, f. 104v, ep. 1324. Përmendet gjithashtu nga: G. Mollat, *Jean XXII*, nr. 7390, si dhe në AA. I, n. 637.

³⁸ AAV, *Reg. Avin.* 9, f. 187v, ep. 1325, dhe AAV, *Reg. Vat.* 68, f. 105 ep. 1325. Përmendet gjithashtu nga: G. Mollat, *Jean XXII*, nr. 7391 si dhe në AA. I, nr. 638.

gjithë sistemin e nominimeve, të konfirmimeve të të gjithë ipeshkvijve, kryeipeshkvijve në botën katolike, të zgjedhjeve në kapitujt katedralë, si dhe të benefiteve të ndryshme për të cilat lëshoi edhe bulën *Ex debito*. Ky centralizim e rriti shumë pushtetin e Selisë së Shenjtë dhe të kishës katolike gjatë pontifikatit të tij.³⁹

Me sa do të provojmë më poshtë, Papa Gjoni XXII e njihte nga afër Ndreun e Krujës. Një ipeshkvi, të cilit i lejohet që të konfirmojë zgjedhjen e një tjetri (kjo bëhet me qëllim që ai të mos ketë nevojë të shkojë në Kurinë Papnore për të marrë konfirmimin),⁴⁰ duhet patjetër të jetë i pranishëm fizikisht në Kurinë Papnore, për të marrë udhëzimet e duhura dhe për t'iu dhënë një përgjegjësi e tillë.⁴¹ Një procedurë e tillë është e pashmangshme, të paktën gjatë kohës së pontifikatit të Gjonit XXII, për shkak të mënyrës strikte të pontifikimit të tij. Ndreu, atëherë, duhet të ketë qenë në Avinjon në qershor të vitit 1318, për t'u autorizuar me autoritetin e plotë që kërkohej për të bërë konfirmimet e sipërpërmendura. Bulat shoqëruese për konfirmimin e Kostës, kryediakonit të Durrësit, Gjon Rubeut dhe Gjon Barbucit, janë bula që i janë dhënë me vete Ndreut, me funksionin që të jenë provë për këta njerëz dhe për ipeshkvitë e tyre, dokumente këto obliguese për të vërtetuar që konfirmimi është bërë nga Papa dhe që ata nuk kanë nevojë më të shkojnë në Avinjon për këtë çështje.

³⁹ Për më shumë në lidhje me këtë dhe me politikën centralizuese të papëve të Avinjonit, shih: G. Mollat, *Les Papes d'Avignon (1305-1378)*, Paris: Librairie Victor Lecoffré, 1924, f. 36-62; shih gjithashtu Aemilius Friedberg, "Corpus Juris Canonici", në *Editio Lipsiensis secunda post Aemilii Dulovici Richter curas instruxit Aemilius Friedberg*, Pars Prima, Decretum Magistri Gratiani, Pars Secunda: Decretalium Collectiones, 2 vol., Reprinted, Akademische Druck, Graz: 1959, lib. I, tit. III, cap. 4.

⁴⁰ Që prej pontifikatit të Gregorit VII, ipeshkvi i zgjedhur që varej direkt nga Papati (*exemptus*), ishte i detyruar të paraqitej në Kurinë Papnore për të marrë konfirmimin e zgjedhjes së tij, por gjithashtu duhej që çdo vit të paraqitej në Kuri për të marrë udhëzime, korrigjime, paralajmërime etj. Kjo ishte pjesë e betimit të tij. Shih: *Corpus Juris Canonici, Liber Extra*. X, 2. 24. 4. "Apostolorum limina singulis annis aut per me aut per certum nuncium meum visitabo, nisi eorum absolvar licentia". Nëse brenda tre muajve pasi është zgjedhur, ai nuk paraqitej në Kurinë Papnore për të marrë konfirmimin, e humbte të drejtën për të qenë ipeshkëv.

⁴¹ *Corpus Juris Canonici, Liber Extra*. X, 2. 24. 4. Për më tej në lidhje me të drejtat që papët i rezervonin vetes, shih gjithashtu: Geoffrey Barraclough, *Papal Provisions: Aspects of Church History Constitutional, Legal and Administrative in the Later Middle Ages*, Oxford: Basil Blackwell, 1935.

Fakti që Ndreu duhet të konfirmojë edhe zgjedhjen e Gjon Barbuçit në Bari të Italisë, që është faktikisht mjaft larg nga Kruja apo Kunavia e Shqipërisë, është një tjetër dëshmi që Ndreu po kthehej nga Avinjoni dhe, meqenëse do të kalonte nga Bari për t'u kthyer në Shqipëri, mund ta përfundonte edhe atë porosi në rrugë e sipër. Rruga nga Shqipëria në Avinjon nuk duhet të ketë zgjatur më shumë se 20 ditë, sepse në bulën e parë që përmendëm më lart, atë të datës 18 maj të vitit 1317, Guljelmi i Montegrans, ipeshkvi i Kunavisë, urdhërohet të paraqitet urgjentisht personalisht brenda 20 ditëve në Avinjon: “brenda 20 ditëve të paraqitet personalisht në prani të papës” (*infra viginti dies se coram pontifice personaliter sistat*). Me sa duket, gjithmonë kalonte ose nga Tarenti ose nga Bari i Italisë. Në fakt, Gorka thotë që nga “Pulia dhe nga qyteti i Brindizit mund të kalohet brenda një nate në Durrës” *De Apulia et de ciuitate brundensima [vna] nocte potest transiri in Duracium*.⁴²

Rrjedha e mëtejshme e ngjarjeve na bën të mos kemi asnjë dyshim për sa u tha më sipër lidhur me famën e mirë të Ndreut. Përkundrazi, mund të shtojmë që Ndreu kishte cilësi të tilla diplomatike, strategjike dhe religjioze që e kishin bindur Papa Gjonin XXII t'i besonte atij një ndër misionet më të vështira që mund t'i besoheshin një kleriku, udhëheqjen e një kryqëzate. Në vitin 1319 ai do të ishte njeriu që do të përfaqësonte Papatin dhe planet e vendimet e tij në tërë lëvizjen antiserbe në Shqipëri.

Planet kryqtare të Papa Gjonit XXII kundër skizmatikëve

Në vitin 1319 do të ndeshemi me shumë bula papnore në të cilat adresohet *Regnum Albaniae* dhe të gjitha këto bula janë në kontekstin e një kryqëzate. Më 17 qershor të vitit 1319, Papa Gjoni XXII, filloi përpilimin e një plani për kryqëzatë kundër mbretit serb. Përpilimi i këtij plani deri tani është menduar dhe interpretuar sikur të ishte ide e anzhuinëve, e Filipit, princit të Tarantos,⁴³ i cili nëpërmjet një letre duket

⁴² Olgierd Górka, *Anonymi Descriptio Europae Orientalis. Imperium Constantinopolitanum, Albaniae, Serbia, Bulgaria, Ruthenia, Ungaria, Polonia, Bohemia, anno MCCCVIII exarata*, Krakov: Academia litterarum Gebethner et Socii, 1916, f. 26.

⁴³ Për më tepër në lidhje me Filipin, princin e Tarantos dhe sundimtarin e Mbretërisë së Arbërisë, shih: Andreas Kiesewetter, “Filippo I d’Angiò, imperatore nominale di Costantinopoli”, *Dizionario Biografico degli Italiani*, vol. 47, Istituto della

se i kishte parashtruar Papa Gjonit XXII gjendjen e keqe të katolikëve shqiptarë nën sundimin e mbretërve serbë dhe i kishte kërkuar atij që t'i mbronte ata me anë të një koalicioni.⁴⁴ Kësaj letre Papa i kthen përgjigje më 12 maj të vitit 1319,⁴⁵ duke e siguruar që ishte i gatshëm për çfarëdolloj iniciative dhe po kështu ishin edhe Karli I Roberti, Mbreti i Hungarisë (1308-1342), si dhe Mlladeni II, bani i Kroacisë dhe i Bosnjës deri në vitin 1322. Pas këtij viti ai u dëbua nga mbreti i Hungarisë, për shkak të ambicieve të tij që preknin interesat e fronit hungarez.

Duke pasur parasysh që Papa Gjoni XXII e njihte gjendjen e katolikëve së paku që nga viti 1317, siç kemi parë nga bulat që kishin lidhje me Ndreun e Krujës, mendojmë që letra e Filipit, princit të Tarentit, nuk solli informacion të ri për të, përveç faktit që Filipi vetë e njihte tepër vonë gjendjen e keqe të katolikëve të Mbretërisë së Arbërisë. Filipi, princi i Tarentit (1294-1331) ishte biri i katërt i Karlit II, Mbretit të Sicilisë. Ishte martuar me Tamara Dukë Komnenën, vajzën e Nikeforit, dhespotit të Romanias (Bizantit) dhe mori titullin princ i Akaiës në vitin 1304. Për shkak të një martese të dytë me Katerinën, vajzën e Charl de Valua (Charles de Valois), u bë trashëgimtar potencial i fronit perandorak të Kostandinopojës në vitin 1312, dhe pas kësaj filloi pretendimet për titullin e perandorit.

Ndoshta ky është shkak se përse Papa Gjoni XXII u drejtohet vetë shqiptarëve për të marrë përsipër kryqëzatën kundër serbëve. Rrjedha e fatit të kryqëzatës, siç do ta shohim më poshtë, tregon që anzhuinët nuk ishin vërtet të interesuar për një kryqëzatë kundër serbëve, por, me sa duket, ishin të detyruar që të hiqeshin si të interesuar për hir të interesave politikë. Në kontekstin e përgatitjes për kryqëzatë kundër skizmatikëve serbë, më 17 qershor të vitit 1319, Papa Gjoni XXII u dërgon letra fisnikëve të Mbretërisë së Arbërisë:

Enciclopedia italiana, Roma: Treccani, 1997, f. 717-723; Oliviero Casanova, *Il principato di Taranto e gli Angioini (Filippo I – 1280-1332)*, Taranto:1908.

⁴⁴ Letra e Filipit nuk ekziston më, por këtë informacion e marrim vesh nga përgjigja që Papa Gjoni XXII i jep atij në letërën e regjistruar në AAV, *Reg. Vat.* 109, f. 162v, ep. 671. Kjo letër përmendet edhe në AA. I, nr. 648, si dhe nga Augustin Theiner, *Vetera monumenta historica Hungariam sacram illustrantia maximam partem nondum edita ex tabularis Vaticanis de prompta, collecte ac serie chronologica disposita ab Augustino*, vëll. I, Vjenë, Romë, Paris: 1860, nr. 1263, f. 830 (cituar më tej: A. Theiner, *Mon. Hung.* I).

⁴⁵ *Po aty.*

Bijve tanë të dashur dhe burrave fisnikë Mentul Musakës, kont i Këlcyrës, Ndre Musaka, marshall i Mbretërisë së Arbërisë, dhe Teodor Musakës, prothosevator; bijve tanë të dashur dhe fisnikëve Guljelm Blinishti, prothosevator, Guljelm Araniti, protholegatur, Kalgjon Blinishti, konti Pal Matrangës, dhe baronëve të tjerë të Mbretërisë së Arbërisë; Birit tonë të dashur, fisnikut Ladislaus Jonimës së Dioklesë dhe kont i Arbërisë në bregdet.⁴⁶

Letrat u adresohen Muzakajve: Mentul Muzakës, kontit të Këlcyrës; Ndre Muzakës, “mareshallit të Mbretërisë së Arbërisë” (*regni Albaniae marescalco*); Theodor Muzakës, *protosevator*-it të Mbretërisë së Arbërisë, të cilët i kishin pronat e tyre në jug të Shqipërisë së sotme. Po kështu u adresoheshin edhe princërve të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut⁴⁷: Guljelm Blinishti - *protosevaton*; Guljelm Araniti - *protholegatur*; Kalgjon (*Calojohanni*) Blinishti, Pal Matrangës, si “dhe baronëve të tjerë të Mbretërisë së Arbërisë” (*ceterisque baronibus regni Albaniae*) dhe Ladislaus-it, kontit të Mbretërisë së Arbërisë.⁴⁸ Në këto letra Papa Gjoni XXII i vë në dijeni fisnikët shqiptarë që ai ishte i informuar se ata po vuanin nën tiraninë e rëndë të mbretit të Serbisë (*sub gravi tyrannide illius regis perfidi Rascie nedum scismatici et religionis christiane totaliter inimici*)⁴⁹ dhe që i përkrahte, madje i nxiste t’i bënin rezistencë kësaj tiranie, duke i siguruar që ai do t’i ndihmonte me të gjitha mundësitë.

⁴⁶ “*Dilectis filiis nobilibus viris Mentulo Musatio comiti Clissaniae Andreae Musatio regni Albaniae marescallo et Theodoro Musatio prothosevastori...; Dilectis filiis nobilib[us] viris Guil[e]lmo Bleniste prothosevastoni. Guil[e]lmo Aranite protholegatur Caloiobani Bleniste comiti Paulo Materango ceterisq[ue] baronibus Regni Albanie...; Dilecto filio nobili viro Bladislao Conome Dioclee et maritime Albanie comiti...*” AAV, *Reg. Vat.* 109, f. 140r, ep. 571. Është dhënë edhe në AA. I, nr. 648, nga A. Taūtu, *Acta Johannis XXII*, nr. 22a; A. Theiner, *Mon. Hung.* I, nr. 1264, f. 831; D. Farlati, *Illyricum Sacrum...*, 64B; dhe një fragment edhe nga baroni, Raynaldi, Laderchii, *Annales Ecclesiastici*, XVIII, Paris, Freiburg: 1887, vol. XV, f. 178, për vitet 1318-1335 (cituar më tej: Raynaldi, *Ann. Eccl.* XVIII).

⁴⁷ AAV, *Reg. Vat.* 109, f. 140-140v, ep. 572 (shënuar si letër sekrete). Përshkruhet pjesërisht nga Raynaldi, *Ann. Eccl.* XVIII, viti 1318-1335, f. 178; përmendet nga D. Farlati, *Illyricum*, 63AB; jepet edhe nga A. Theiner, *Mon. Hung.* I, nr. 1264, f. 831; si dhe në AA. I, nr. 649.

⁴⁸ AAV, *Reg. Vat.* 109, f. 140v, ep. 573.

⁴⁹ *Po aty.*

Për ta plotësuar këtë kuadër duhet shtuar që nga mënyra, sesi Papati u drejtohej forcave politike shqiptare, të bën të kuptosh që ai, në radhë të parë, nxiste bashkimin e këtyre forcave, si forca politike dhe, në këtë aspekt, nuk duhet marrë si rastësi fakti që Papati u drejtohet atyre në grupe: në një letër Muzakajve, në një tjetër Blinishtëve, Aranitëve, Matrangëve dhe në një tjetër Ladislaus Jonimës (Radislaut Gonomes), kontit të Dioklesë dhe të Arbërisë bregdetare, me pothuajse të njëjtat fjalë, të njëjtat udhëzime dhe u sugjeron të njëjtin person-kontakti me rol udhëheqës: Ndreun e Krujës. Në këtë kontekst, Ndreu i Krujës kishte edhe një mision indirekt: atë të bashkimit të forcave politike të Mbretërisë së Arbrit.

Karakteri katolik i Mbretërisë së Arbërisë

Në botimin e ri të “Historisë së Shqipërisë”, bulat papnore interpretohen sikur të ishin fisnikët shqiptarë ata që donin të braktisnin ritin ortodoks dhe të përfaqonin katolicizmin, duke u ndarë edhe kishërisht nga pushtuesit serbë,⁵⁰ por letrat origjinale nuk të lënë të kuptosh një gjë të tillë. Papa Gjoni XXII u drejtohet atyre si “bijve të dashur” (*dilectis filiis*)⁵¹ dhe një protokoll i tillë nuk u bëhej kurrë atyre që nuk ishin tashmë katolikë të devotshëm.⁵² Po kështu i drejtohet madje edhe Ladislaus-it,⁵³ i cili nga emri është konkluduar se duhet të jetë sllav dhe i ritit lindor.⁵⁴ Është pikërisht emri i tij ai që i ka ngatërruar shumë studiues seriozë që të mos e quajnë atë katolik. Fakti që Papa i drejtohet atij si “birit të dashur” (*dilecto filio*) duke e konsideruar atë katolik të devotshëm nuk duhet të na çudisë, sepse dihet tashmë që Dioklea ishte nën ndikimin e princeshës katolike, gruas franceze të Mbretit Stefan I Urosh, Helenës dhe ajo kishte vazhduar një aktivitet të dendur katolik

⁵⁰ Skënder Anamali, *Histori e Shqipërisë*, vëll. I, Tiranë: Toena, 2002, f. 273.

⁵¹ Në lidhje me kuptimin e një protokollit të tillë, shih më tej: Thomas Frenz, *Papsturkunden des Mittelalters und der Neuzeit*, Stuttgart: F. Steiner, 2000, f. 44-46.

⁵² *Po aty*, f. 44-46.

⁵³ AAV, REG. VAT. 109, F. 140V, EP. 573.

⁵⁴ Claudine Delacroix-Besnier, “Les Ordres mendiants et l’expansion de l’Église latine dans les Balkans”, në *Alle frontiere della Cristianità. I frati Mendicanti e l’evangelizzazione tra ‘200 e ‘300. Atti del XXVIII Convegno internazionale, Assisi, 12-14 ottobre 2000*, Centro Italiano di studi sull’alto Medioevo, Spoleto: 2001, f. 245; AA. I, nr. 650, komenti i bërë nga Shufflaj.

dhe një korrespondencë mjaft të gjallë me Papatin në lidhje me çështjet e besimit.

Stefan Dragutini, i cili sundoi i vetëm për një periudhë të shkurtër në vitet 1276-1282, pasi ndau tokat nën sundimin e tij në tri pjesë, midis dy bijve dhe gruas së tij, Helenës, kësaj të fundit i la pronat e bregdetit që nga Dubrovniku deri në Shkodër, toka këto që për një kohë të gjatë u njohën si “pronat e nënës mbretëreshë” (*domina regina mater*). Në brendësi të vendit i la Plavën (pranë Gucisë) në Limin verior dhe kështjellën Brnjaci në pjesën e sipërme të Ibrit.⁵⁵ Në këtë mënyrë, Helena e kishte tërë Dioklenë nën sundimin e saj të plotë dhe e vazhdoi aktivitetin e saj katolik dendur në këto territore, duke i lënë Papatit dorë të lirë për sa u përket çështjeve religjioze, gjë që përligjite më vonë edhe planet politike që Papati përgatiste kundër skizmatikëve në këto zona.

Helena lavdërohet për oratorinë, mirësinë, bujarinë, përshpirtshmërinë dhe për mënyrën e paqortueshme të jetesës. Në zonën e Dioklesë, ajo rinovoi Drishtin dhe qytete të tjera që kishin qenë shkatërruar nga pushtuesit mongolë; themeloi kisha dhe manastire katolike në Kotorr, në Tivar, në Ulqin e në Shkodër, dhe në brendësi të vendit themeloi manastirin serb të Gradacit në Ibër. Për nga prejardhja, Mbretëresha Helenë ishte franceze dhe me sa shihet nga letrat e Karlit I dhe II Anzhu, ishte kushërirë e tyre.⁵⁶ Në këtë kuadër, nuk ka pse të jetë çudi që një sllav* nga zona e Dioklesë të jetë katolik i devotshëm dhe një ndër forcat kryesore politike të Mbretërisë së Arbërisë, që në thelb ishte një mbretëri katolike. Supozimi që Ladislaus nuk mund të ishte sllav nuk duhet të na lëkundë as në lidhje me atë që kemi pohuar, që Papati dëshironte të forconte identitetin lokal dhe katolik të mbretërisë.

Duke pasur parasysh që në Mesjetë nuk ekzistonte koncepti komb, pra as kriteret që përbëjnë një komb siç janë gjuha, zakonet dhe kultura e përbashkët si mjet identiteti kombëtar dhe hapësira e përbashkët gjeografike, mbretëritë nuk bazoheshin në të tilla kritere që janë moderne

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ K. Jireček, *Geschichte der Serben ...*, I, f. 318-319, 328.

* Nëse Ladislaus ishte apo nuk ishte sllav, kjo në fakt nuk mund dhe nuk duhet të përcaktohet vetëm nga emri i tij. Po të niseshim nga kjo logjikë, vetëm nga emri si kriter për origjinën, atëherë edhe mbretërit hungarezë, me emrin Ladislaus [Vladislavi] do të na dilnin sllavë.

për nga konceptimi.⁵⁷ Mbretëria e Arbërisë, që ishte një formacion politik i mbështetur kryesisht mbi kriterin “fe katolike,” mund të ketë qenë shtrirë deri afër Dubrovnikut, ku ishin pronat e Helenës, Nënës Mbretëreshë, nga ku vinte Ladislav Jonima, konti i Dioklesë dhe i Arbërisë bregdetare. Megjithatë, këta kufij veriorë janë të diskutueshëm dhe nuk mund të përcaktohen me siguri, përderisa kemi një ndërthurje të elementëve katolikë e sllavo-ortodoksë që bashkëjetojnë.

Karakterit vendor e lokal i Mbretërisë së Arbërisë

Nuk ndodh shpesh që Papati t’i drejtohet me emër dhe me titull secilit prej fisnikëve të një mbretërie. Rasti më i zakonshëm është që Papa i drejtohet me bulë mbretit, dhe fisnikëve në përgjithësi, pa përmendur emrat e fisnikëve. Me këtë akt, Papa Gjoni XXII dëshironte njëkohësisht të tregonte që ai e njihnte Mbretërinë e Arbërisë me këta kufij dhe si forca politike udhëheqëse të saj këta fisnikë, më shumë se një mbret cilido qoftë ai.⁵⁸ Në fakt, zyrtarisht shqiptarët njihnin si zot Filipin e Tarantos, të birin e Karlit II Anzhu, por ai nuk adresohet dhe me sa duket as nuk njihet si mbret i shqiptarëve në bulën papnore, ndoshta për të mos ulur vlerat e vëllait më të madh, Robertit, që ishte Mbret i Napolit.

Në një dokument papnor të 12 majit të vitit 1319, ku Papa Gjoni XXII i drejtohet Filipit, ai e quan atë “Birit të dashur, burrit fisnik, Filipit, djalit të mbretit të ndërë të Sicilisë, princit të Tarantos” “(*Dilecto filio nobili viro Philippo clarae memoriae regis Siciliae filio, principi Tarentino*)⁵⁹, por asgjë më shumë se kaq për sa i përket lidhjes së tij me Mbretërinë e Arbërisë⁶⁰, pra pa e njohur atë si mbret të Arbërisë. Këtu

⁵⁷ Patrick J. Geary, *Miti i Kombeve: Origjinat mesjetare të Evropës (The Myth of Nations. The Medieval Origins of Europe)*, përkthyer nga Etleva Lala, Tiranë: Ombra GVG, 2011.

⁵⁸ Është për t’u theksuar edhe që Anonimi i Gorkës i përshkruan marrëdhëniet midis mbretit dhe Mbretërisë së Arbërisë në vitin 1308, si mbretëri pa mbret: *partem huius regni cum ciuitate duracena tenet nunc princeps tarentinus filius regis sycilie, ... Dictum Albanie regnum nunc regem nullum habet, sed terra diuiditur per principes terre, qui ipsam regunt et ipsi nulli subsunt*. Shih: O. Górká, *Anonymi Descriptio Europae Orientalis, “Imperium Constantinopolitanum, Albaniae, Serbia, Bulgaria, Ruthenia, Ungaria, Polonia, Bohemia, anno MCCCVIII exarata”*, f. 26, 27.

⁵⁹ AAV, *Reg. Vat.* 109 (Litt. Secr.) f. 162v ep. 671; AA. I, no. 648; A. Theiner, *Mon. Hung.* I, nr. 1263, f. 830; A. Taūtu, *Acta Johannis XXII*, nr. 22, f. 43.

⁶⁰ Sovranët e Napolit e kërkonin gjithmonë titullin e mbretërisë dhe këtë titull e kishte edhe Filipin i Tarantos. Në fillim, që nga viti 1304, kur Karli II Anzhu ia dorëzon

duhet të mbajmë parasysh edhe faktin që Mbretëria anzhvine e Arbërisë ishte reduktuar tashmë që në vitin 1292 vetëm në qytetin e Durrësit dhe në ca territore rreth tij⁶¹ dhe nuk mund të kishte kurrsesi të gjitha territoret që Papati ia njeh Mbretërisë së Arbërisë në bulat e mësipërme papnore. Konkluzioni i natyrshëm i të gjithë kësaj është që Papa Gjoni XXII njihte karakterin lokal-vendor të kësaj mbretërie dhe ishte i interesuar të theksonte këtë identitet të saj. Nga këto dokumente kuptojmë pra, që Kuria Papnore e Papës Gjoni XXII (1316-1334), jo vetëm që njihte statusin e Mbretërisë së Arbërisë si mbretëri legjitime, por madje njihte dhe saktësonte kufijtë e kësaj mbretërie, njihte mirë edhe klasën udhëheqëse të saj që në sytë e Papatit ishte fisnikëria vendëse.

Duke u nisur nga këto dokumente papnore, që kanë si qëllim që të arrijnë t'i bashkoinë të gjitha forcat politike shqiptare, Shuflaj ka arritur të përcaktojë thelbin e Shqipërisë etnike të Mesjetës. Si kufirin jugor ka marrë territoret që posedonte Mentul Muzaka që shkonin deri në Këlcyrë,⁶² si kufirin lindor ka marrë territoret e Ohrit dhe të Dibrës, ku shtrinin sundimin e tyre Matrangët dhe si kufirin verior ka marrë territoret e Blinishtëve që zotëronin Mirditën deri në Ulqin dhe Danjë. Do të ishte më e saktë, nëse këto territore do t'i konsideronim si territoret e Mbretërisë së Arbërisë, si formacion politik dhe jo si territoret e Shqipërisë etnike që shtriheshin shumë më gjerë se kaq. Duke qenë një mbretëri me karakter katolik, në këtë formacion politik nuk janë përfshirë territoret shqiptare që ishin të rritit bizantino-ortodoks, siç duhet të kenë qenë në këtë kohë Topiasit.⁶³ (Topiasit duke qenë se kishin lidhje

mbretërinë Filipit të Tarantos, Filipi i Tarantos, e quante veten "despotus," e më vonë që nga viti 1306 e në vijim, e quante veten "zot të Mbretërisë së Arbërisë" (Regni Albaniae dominus), G. M. Monti, "Ricerche sul dominio angioino ...", f. 6). Për këtë argument shih Andreas Kiesewetter, "I principi di Taranto e la Grecia (1294-1383)", *Archivio storico pugliese*, vol. 40, Bari: A. Cressati, 2001, f. 53-100, f. 69.

⁶¹ Shih G. M. Monti, "Ricerche sul dominio angioino ...", f. 6; po ai, *Mezzogiorno d'Italia nel medioevo ...*, f. 80.

⁶² *Giovanni Musachio (Gjon Muzaka)*, "Storia e genealogia della casa Musachia scritta da Giovanni Musachio" *despoto d'Epiro a suoi figli nel 1510*, në Karl Hopf, *Chroniques Greco-Romanes inédites ou peu connues*, Berlin: Weidmann, 1873, f. 270-366.

⁶³ Është për t'u tërhequr vëmendja te mospërmendja e Topiajve në këtë listë të fisnikëve shqiptarë. Me sa duket, Topiajt nuk konsideroheshin si katolikë nga Papati në këtë periudhë.

martesore me anzhuinët, mund të konsiderohen më afër tyre se prijësit e tjerë shqiptarë).

Marrëdhëniet e Selisë së Shenjtë me anzhuinët në përgjithësi, në kohën e pontifikatit të Gjonit XXII, me sa duket nuk ishin të mira. Po të kemi parasysh që mbretëria e anzhuinëve ishte krijuar si feud pontifikal dhe ishte quajtur krahu shekullor i kishës në Itali, një mendim i tillë mund të duket tepër i guximshëm, aq më tepër që marrëdhëniet e anzhuinëve deri në kohën e Papa Inocentit V mund të përshkruhen si të mira. Një hipotezë e tillë, e marrëdhënieve jo të mira të Papa Gjonit XXII me Mbretërinë e Sicilisë, është ngritur dhe argumentuar edhe më herët nga studiuesi i mirënjohur Gennaro Maria Monti.⁶⁴ Synimet më armiqësore të Papa Gjonit XXII ndaj anzhuinëve, sipas Montit, u shpalosën kur Papa tentoi të formonte një mbretëri laike vasale të kishës në Italinë Veriore. Megjithëse kjo përpjekje dështoi për shkak të kundërshtimit të të gjithë Italisë, bashkë me disa rrethana të tjera,⁶⁵ duke shënuar kështu kulmin e krizës së mbretërisë anzhuine, e cila sipas Montit, shënoi edhe fillimin e degradimit të kësaj mbretërie.⁶⁶

Se sa të forta ishin interesat e anzhuinëve ndaj Mbretërisë së Arbërisë dhe se çfarë dëmi u shkaktonte Papatit anzhuinëve, duke forcuar karakterin lokal të mbretërisë dhe duke nxitur në këtë mënyrë që kjo mbretëri të bëhej një strukturë politiko-organike, e ilustron shumë bukur Monti kur përshkruan karakteristikat e Mbretërisë së Sicilisë:

“Nga ana tjetër, Mbretëria [e Sicilisë] nuk kishte mundur që, si shtetet e tjera, të zgjeronte pushtetin e saj, sepse e shtrënguar midis detit dhe shtetit të kishës, me të cilin kufizohej, nuk mund të prekte kufijtë për arsye të lidhjes fetare dhe politike me Papatin: ajo mundte dhe tentoi të shtrihej vetëm në zotërime të largëta dhe joorganike, pak të mbrojtura dhe pa kufij territorialë, për të mos u

⁶⁴ Papa Benedikti XII, pasardhës i Gjonit XXII, e konsideron Robertin si një ndër princërit katolikë më të devotshëm të Papatit, por jo më si krahu shekullor të kishës në Itali, siç kishte qenë para pontifikatit të Papës Gjoni XXII. Shih G. M. Monti, “Studi di Storia Angioina...”, f. 19-21.

⁶⁵ Shih Romolo Caggese, *Roberto d'Angiò e i suoi tempi*, Firenze: Bemporad Collection, 1922, f. 197. Lufta midis perandorisë dhe komunave, midis Guelfëve dhe Gibelinëve, midis instiktit latin e konceptimit gjerman.

⁶⁶ Shih G. M. Monti, *Studi di Storia ...*, f. 1-24. Monti është i mendimit që kriza e cila rrënoi Mbretërinë e Sicilisë, nuk erdhi as nga fundi i dinastisë Sveve, as nga Vespri sicilian dhe as nga qeverisja e Xhoanës së Anzhuinëve, por nga jashtë, nga ndryshimi i politikës italiane dhe europiane ndaj Robertit të Napolit.

përplasur me armiq më të pushtetshëm, me qëllim që mbretëria të mbetej e paprekur për nga pozicioni gjeografik dhe për nga homogjeniteti i madhësisë, nëse ato zotërime të largëta do të duhet të humbnin pak nga pak ose të liheshin vetë, sepse nuk ia vlente barra qiranë që të shpenzohej ar e ushtri për t'i mbrojtur.”⁶⁷

Mbretëria e Arbërisë si instrument politik në duart e Selisë së Shenjtë

Vërtet që Mbretëria e Arbërisë kishte qenë një “zotërim joorganik, pak i mbrojtur, pa kufij territorialë,” kur ishte krijuar nga Karli I Anzhu, por tashmë rrethanat kishin ndryshuar. E vënë shpirtërisht nën autoritetin e Papatit, forcat politike të kësaj mbretërie, me sa duket konsideroheshin si krahu shekullor i Papatit për çështjet shpirtërore në Ballkan. Anzhuinët, që nuk u pritën mirë nga shqiptarët, por që me sa duket kishin humbur shumë reputacion edhe në sytë e Papa Gjonit XXII, për shkak të lidhjeve që ata kishin krijuar dhe ushqyer me serbët skizmatikë dhe me bullgarët,⁶⁸ nuk mund të pretendonin që ta cenonin përsëri Mbretërinë e Arbërisë, sepse në këtë mënyrë do të cenonin interesat e Papatit, me të cilin forcat politike të vendit duket se ishin lidhur ngushtë tashmë. Nga ana tjetër, Mbretëria e Arbërisë që nuk është zotërim i largët, nuk mund të konsiderohet më as territor joorganik, sepse ka një unitet të brendshëm,

⁶⁷ *Po aty*, f. 22-23. “... *D'altra parte, il Regno [di Sicilia] non aveva potuto, come quelli altri Stati estendere la propria potenza perchè stretto fra il mare e lo Stato della Chiesa, il cui confine non poteva violare per ragioni religiose e politiche di aderenza al Papato: esso poteva, e tentò, espandersi solo in domini lontani e non organici, poco agevolmente difendibili, senza contiguità territoriale, sì che doveva accadere che all'urto dei nemici sempre più potenti, se il Regno restò intatto per la sua posizione geografica e per la sua omogeneità e grandezza, quei lontani domini dovessero perdersi volta a volta o esser lasciati a sè stessi, perchè non valeva la pena di profondere oro e milizie per difenderli*”.

⁶⁸ Shih: Francesco Carabellese, *Carlo d'Angio nei rapporti politici e commerciali con Venezia e l'oriente*, University of Michigan Library, 1911, f. 48. Karli I kishte shkëmbim ambasadorësh me sovranët serbë dhe bullgarë, si dhe me Mbretërinë e Sagarach (sic!). Për këtë shih G. M. Monti, *Mezzogiorno d'Italia nel medioevo...*, f. 93; si dhe George Yver, *Le Commerce et les marchands dans l'Italie méridionale au XIII^e et au XIV^e siècle*. Paris: 1903, f. 13-17. Karli II dhe Roberti kishin raporte të ngushta me Uroshin, Mbretin e Serbisë, i cili i bën dhuratë ikonën e tij të famshme bazilikës së Shën Nikollës së Barit. Bani i Sklavisë dhe perandori i Bullgarisë marrin madje pensione nga anzhuinët si dhe martohen me princesha të gjakut mbretëror.

të paktën për të kundërshtuar armiqtë e jashtëm dhe, me sa duket, anzhuinët nuk duan të vazhdojnë të shpenzojnë “ar e ushtri” për t’i mbajtur të nënshtuar.

Për t’u kthyer përsëri te Ndreu i Krujës, duhet të vëmë në pah se në të gjitha këto letra të Papa Gjonit XXII, ai rekomandon Ndreun si njeriun e tij të besueshëm, i cili do t’u japë udhëzime me gojë dhe të cilit duhet t’i besojnë deri në fund: “Përveç kësaj, vëllai ynë i nderuar Ndreu, ipeshkëvi i Krujës, të cilit do të mund t’i jepni besimin tuaj, do t’ju shprehë me zë të gjallë plotësisht dashurinë tonë” (*Super hiis autem venerabilis frater noster Andreas episcopus Croensis affectum nostrum oraculo vive vocis plenius vobis aperiet, cui exinde fidem poteritis credulam adhibere*).⁶⁹ Fakti që Ndreu ishte zëri i gjallë i Papatit, të cilin vetë Papa e rekomandon për të instruktuar dhe për t’u dhënë udhëzime të gjitha forcave politike të Mbretërisë së Arbërisë në kryqëzatën që po përgatitej kundër sundimit serb në vitin 1319, tregon qartë për rëndësinë e këtij ipeshkvi dhe për favorin që kishte fituar në sytë e Papa Gjonit XXII, në saje të virtyteve të tij.

Në rastin në fjalë, nuk disponojmë letra me përshkrimin e misionit dërguar Ndreut, gjë që tregon se ai ishte i lirë të instruktonte sipas mendjes së tij, si një privilegj jashtëzakonisht i madh dhe që flet për një mirëbesim të jashtëzakonshëm të Papa Gjonit XXII ndaj këtij ipeshkvi. Kryqëzata në fjalë, në fakt nuk u realizua kurrë. Arsyet për këtë duhen kërkuar së pari në problemet organizative dhe politike që Selia e Shenjtë pati me forcat politike perëndimore,⁷⁰ por edhe në politikën diplomatike të Uroshit II, Mbretit të Serbisë, që i premtoi Papës se do të pranonte besimin katolik bashkë me popullin e tij, gjë që në fakt nuk ndodhi kurrë.

Që Filipi i Tarantos kishte pasur dhe do të vazhdonte të kishte marrëdhënie të mira me mbretërit serbë, del qartë edhe nga planet që ata guxojnë të bëjnë duke u mbështetur në marrëdhëniet pozitive me të. Gjatë luftës kundër kunatit të të vëllait, Vladislavit, në vitin 1323, Uroshi II tentoi që të vendoste lidhje miqësie familjare me anzhuinët e Napolit, duke kërkuar për grua vajzën e Filipit të Tarantos. Me këtë rast klerikët e

⁶⁹ *Po aty*. Duhet shikuar me kujdes fundi i secilës nga letrat papnore.

⁷⁰ Për një trajtim të gjerë të kësaj çështjeje, shih: Norman Housley, *The Italian Crusades: The Papal-Angevin Alliance and the Crusades against Christian Lay Powers, 1254-1343*, Oxford University Press: 1986; po ai, *The Avignon Papacy and the Crusades, 1305-1378*, Oxford: Clarendon Press, 1986; Kenneth M. Setton, *A history of the Crusades*, vol. III, Wisconsin: University of Wisconsin Press, 1985.

tij, fisnikët dhe populli i Mbretërisë së Serbisë u treguan të gatshëm që të përfundonin skizmën dhe t'i nënshtroheshin Kishës Romane. Në këtë mënyrë, ai donte të mbrohej nga hungarezët dhe nga aleancat e ndryshme që po krijoheshin kundër serbëve. Papa Gjoni XXII i besoi dhe dërgoi me misionin që të kryente bashkimin e kishave Bertrandin, ipeshkvin e Brindizit,⁷¹ ashtu siç u përpoq më vonë që nëpërmjet nuncëve apostolikë, ndër ta edhe një shqiptar, të konvertonte Carin Stefan Dushan.⁷²

Pas paqes me Perëndimin, në vitin 1319, Uroshi II bashkë me gruan e tij Simonën, vajzën e Perandorit bizantin Androniku II dhe me djalin Konstantin, ndërtoi një altar prej argjendi për kishën e Shën Nikollës së Barit, me mbishkrime latine.⁷³ Nëse i referohemi studiuesit të mirënjohur të historisë së sllavëve, në lidhje me tekstin e mbishkrimit: “Zot i të gjithë tokave nga deti Adriatik deri në lumin e madh të Danubit,”⁷⁴ atëherë duhet të mendojmë që anzhuinët kanë qenë shumë tolerantë me serbët, sepse u kanë njohur supremacinë edhe në territoret që duhej të ishin të tyre (të anzhuinëve).

Një strategji e tillë e mbretërve serbë do të përdorej vazhdimisht gjatë shek. XIV, kur shumë kryqëzata planifikoheshin kundër tyre, për shkak të politikave diskriminuese që ndiqnin ndaj katolikëve. Të tilla plane për kryqëzata ku, në fakt, forcat politike shqiptare vendosen në qendër të këtyre planeve, regjistrohen në vitin 1331, 1336 dhe në vitet '50 të shek. XIV. Është gjithmonë e njëjta strategji që i shpëton serbët në momentin e fundit kur fushatat e koalicioneve bëhen gati për të filluar. Persekutimet e katolikëve na bëhen të ditura edhe nga përshkrimet e udhëtarëve, siç është rasti i vitit 1308 “Por pjesa tjetër e së njëjtës mbretëri dhe mbreti janë skizmatikë të pabesë dhe për këtë arsye edhe ata i persekutojnë katolikët e përmendur dhe veçanërisht shkatërrojnë kishat e latinëve, shkatërrojnë dhe sulmojnë prelatët dhe i zënë robër” (*Ceteri autem eiusdem regni et rex sunt scismatici perfidi et ideo nimium*

⁷¹ K. Jireček, *Geschichte der Serben ...*, I, f. 359.

⁷² Etleva Lala, *Regnum Albaniae and the Holy See: The Western Visions of a Borderline Nobility*. Ph.D. Thesis submitted at Central European University, Department of Medieval Studies, Budapest: 2008, f. 120.

⁷³ Për këtë shkruajnë: Mauro Orbini, *Il Regno de gli Slavi hoggi corrottamente deti Schiavoni*, Pesaro: 1601, f. 255; Vicentije Makušev, *Istroriëeskia Razyskania o Slavjanah v Albani v Srednie Veka*, Varšava: 1871, f. 13, 62; K. Jireček, *Geschichte der Serben ...*, I, f. 353.

⁷⁴ Francis Dvornik, *Gli Slavi nella storia e nella civiltà europea*, Bari: 1968, f. 163.

persequuntur dictos catholicos, et permaxime ecclesias latinorum destruunt, disipant, et inuadunt prelatos et captiuant et plura inexquisita mala faciunt.)⁷⁵

Arsyeja se përse Selia e Shenjtë e përkrahte karakterin vendor të kësaj mbretërie nuk është shumë e vështirë për t'u hamendësuar. Në Mesjetë bashkimi i Europës, të cilit sot i kushtohet caq vëmendje dhe rëndësi, ishte realizuar nëpërmjet kishës katolike, në krye të së cilës ishte Papa dhe Kuria Papnore. Kisha katolike nuk luante thjesht një rol shpirtëror, por kishte një dorë shumë të fuqishme mbi të gjithë jetën politike, sociale, ekonomike, kulturore etj., të Europës së asaj kohe. Këtij “bashkimi evropian” megjithatë, i mungonte pjesa lindore, e cila ishte kryesisht nën ndikimin skizmatik serb apo bizantin. Pas kryqëzatës së katërt, kur Bizanti mori të tatëpjetën, shpresat e Papatit për një “bashkim të plotë evropian” u rritën shumë. Nëse, deri në fund të shek. XIII, Papati ishte përpjekur që këtë bashkim ta arrinte me luftë, me anën e kryqëzatave, karakteristike për shek. XIV është që ai u kushton rëndësi shumë të madhe edhe rrugëve diplomatike.

Duke parë që shqiptarët nuk duronin sundimtarë të huaj, Selia e Shenjtë përdori me ta rrugën diplomatike, d.m.th duke bërë kompromis dhe duke u ofruar atyre atë që shqiptarët vetë kërkonin: mbretëri me karakter vendor, por që të ndihmohej të përballonte rrezikun e jashtëm të pushtuesve sllavë e bizantinë. Në rastin e Mbretërisë së Arbërisë, të cilën Papati e shikonte si kështjellë të katolicizmit në Ballkan, ai ishte i interesuar që forca politike vendore të kishte hapësirë vetëvepruese dhe të kishte identitetin e saj, sepse vetëm në këtë mënyrë ajo do të mund t'u rezistonte forcave pushtuese serbe dhe bizantine. Nëse këto pushtete vendore nuk do të kishin karakter dhe identitet të fortë si forcë politike, ato rrezikonin të shuheshin e të asimiloheshin nga pushtuesit serbë e bizantinë dhe Selia e Shenjtë nuk do të kishte asnjë përfitim nga kjo dhe pothuajse asnjë shans tjetër për të vendosur influencën e saj në Ballkan. Në këtë mënyrë, Papati jo vetëm që i dha njohje ndërkombëtare Mbretërisë së Arbërisë, por edhe u interesua praktikisht për të forcuar karakterin dhe identitetin e saj vendor. Për këtë, ai e nxiti dhe e përkrahu atë që të merrte iniciativa për ta treguar veten të pjekur e të pavarur dhe për të luajtur rol si e tillë në arenën ndërkombëtare, siç ishte rasti i kryqëzatave të planifikuara kundër skizmatikëve sllavo-ortodoksë.

⁷⁵ O. Górká, *Anonymi Descriptio ...*, f. 30.

Sigurisht që nuk janë të paktë studiuesit që janë marrë me Mbretërinë e Arbërisë, me karakterin, me funksionimin, me rolin dhe me rëndësinë e saj, por ai që dëshiron të studiojë në thellësi shek. XIV e ka të pamundur të vazhdojë punën e tij kërkimore-shkencore për këtë shekull, pa u ndalur në mënyrë të veçantë te ky formacion politik, për të ndriçuar ndonjë aspekt të veçantë të kësaj mbretërie, gjë që shërben për të fituar një botëkuptim më të plotë për rrethanat historiko-politike, socio-religjioze në të cilat jetonte populli shqiptar në shek. XIV. Në këtë studim, marrëdhëniet e Mbretërisë së Arbërisë me Papatin, i cili në Mesjetë ishte pushteti qendror i Mesjetës europiano-perëndimore, tregojnë që elementi shqiptar jo vetëm që është trajtuar me seriozitet shumë kohë para daljes së Skënderbeut në skenën politike europiane të asaj kohe, por është konsideruar si partner në planet e fuqive të Europës Perëndimore për planet që ata kishin në këto anë të Europës. Kjo lloj njohje dhe ky lloj targetimi i shqiptarëve si perëndimorë në një kohë kur i gjithë Ballkani Perëndimor ishte jashtë duarve të Selisë së Shenjtë, sigurisht që krijoi te shqiptarët ndjenjën e të qenit të rëndësishëm si shqiptarë dhe jo si vartës të perandorive që ekzistonin në Ballkan.

S u m m a r y

EMPOWERING THE *REGNUM ALBANIAE* BY THE HOLY SEE

Although *Regnum Albaniae* was officially declared exactly 750 years ago, on February 21, 1272, its real significance started to be displayed in the second decade of the fourteenth century, long after the physical body of its king that had perished. The other body, according to Kantorowitz, the political body of the *Regnum Albaniae*, was used by the Holy See to create a union of all the Catholic-interested parties in the Western Balkans, in order to empower a political and religious stronghold in the Balkans, which would not allow the Eastern Rite of the “schismatics” take hold of the whole Balkans. This union was even more organic and long-lasting, when the Albanians understood it as an expression of their own identity and by combining their desire to be free from the Serbian kings with their desire to be recognised as an independent political power, they embraced the idea of being the representatives of the *Regnum Albaniae* in the international political and religious arena of the time. This led to long-lasting identity of the Albanians as the Catholics of the Balkans.